



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË APELIT
GJIROKASTËR**

Nr _____ Prot.

Gjirokastrë më 27.02 .2019

ANALIZË

MBI TREGUESIT E PUNËS SË KRYER GJATË VITIT 2018

Prokuroria e Apelit Gjirokastrë, duke iu referuar shqyrtimeve gjyqësore të apelineve të ardhura nga Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore Gjirokastrë, Sarandë dhe Përmet gjatë vitit 2018 ka shqyrtuar 127 çështje themeli (50 më pak se viti i kaluar), me 185 të pandehur (33 më pak se viti i kaluar), nga të cilët 109 (41 më pak se viti i kaluar) me masë sigurimi “arrest në burg”. Janë shqyrtuar 111 (29 më pak se viti i kaluar) çështje me 143 (dy më pak se viti i kaluar) persona të dyshuar, me objekt vlerësim arresti ose ndalimi dhe caktim mase sigurimi, si dhe është marë pjesë në gjykim dhe për 45 (22 më pak se viti i kaluar) çështje gjyqësore penale me objekt kundërshtim vendim mosfillimi, rivendosje në afat, me të dëmtuar akuzues, kundërshtim zgjatje afati paraburgimi etj.

Për vendimet e themelit janë shqyrtuar 48 çështje me 64 të pandehur, nga të cilët 38 me masë sigurimi arrest në burg, që i përkasin **Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë**. 56 çështje me 90 të pandehur, nga të cilët 53 të pandehur me masë sigurimi “arrest në burg” për **Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Sarandë** si dhe 23 çështje me 31 të pandehur nga të cilët 18 me masë sigurimi “arrest në burg” për **Prokurorinë e Rrethit Rrethit Gjyqësor Përmet**.

Gjithashtu në Gjykatën e Apelit Gjirokastrë janë shqyrtuar dhe 45 çështje penale me objekt gjykim kërkesë për prishjen e vendimit të mosfillimit, rivendosje në afat, me të dëmtuar akuzues, kundërshtim zgjatje afati paraburgimi, hetimi etj.

Për vitin 2019, janë mbartur 18 çështje, me 22 të pandehur nga të cilët 4 me masë sigurimi “arrest në burg”.

Nga Prokuroria e Apelit Gjirokastrë gjatë vitit 2018 janë ushtruar 8 rekurse (9 më pak se viti i kaluar) në Gjykatën e Lartë, kundër vendimeve të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, gjithashtu janë nxjerrë dhe 11 Urdhëra Ekzekutimi.

1. Treguesit e përgjithshëm

Për vendimet e themelit janë shqyrtuar 48 çështje me 64 të pandehur, nga të cilët 38 me masë sigurimi arrest në burg, që i përkasin **Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë**, 56 çështje me 90 të pandehur nga të cilët 53 të pandehur me masë sigurimi “arrest në burg” për **Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Sarandë** si dhe 23 çështje me 31 të pandehur, nga të cilët 18 me masë sigurimi “arrest në burg” për **Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Përmet**. Gjithashtu në Gjykatën e Apelit Gjirokastrë janë shqyrtuar dhe 45 çështje penale me objekt gjykimi kërkesë për prishjen e vendimit të mosfillimit, rivendosje në afat, me të dëmtuar akuzues, kundërshtim zgjatje afati paraburgimi etj.

Për vitin 2019, janë mbartur 18 çështje, me 22 të pandehur nga të cilët 4 me masë sigurimi “arrest në burg”.

Treguesit për vendime themeli.

Duke iu referuar shqyrtimeve të vendimeve të themelit rezulton se 20 apeline, (36 apeline më pak se viti 2017), janë ushtruar nga Prokurorët, ku 10 apeline janë bërë për pafajsi, 2 apeline për pushim çështje, 2 apeline për ndryshim kualifikimi dhe 60 apeline për masë dënimi të butë.

Është hequr dorë nga apeli i prokurorëve të Shkallës së Parë në 3 raste, ndërsa nga të pandehurit është hequr dorë nga ankimi në 9 çështje të gjykuara.

Nga Prokuroria e Apelit Gjirokastrë janë përkrahur 19 apeline të Prokurorëve. Ndërsa nga të pandehurit janë ushtruar 44 apeline. Nga 12 apeline për pafajsi ose pushim çështjeje nga Gjykata e Apelit është dhënë fajësi, duke ndryshuar vendimet e gjykatave të Shkallës së Parë, për 2 vendime. Janë lënë në fuqi 9 vendime për pafajësi ose pushim çështjeje.

Treguesit për vendime masa sigurimi

Përsa u përket masave të sigurimit, nga 111 apeline (29 më pak se viti i kaluar), 18 (1 më shumë nga viti i kaluar) apeline janë bërë nga Prokuroritë dhe 123 (5 më pak nga viti i kaluar) apeline janë bërë nga personat e dyshuar. Nga apelimet e prokurorëve në 11 raste është hequr dorë nga prokurori i Apelit, ndërsa për 1 apelim është hequr dorë nga personi i dyshuar. Nga **6** apeline të Prokurorëve

janë pranuar nga gjykata e Apelit 2 apeline duke vendosur masën e sigurisë “arrest në burg” ose masa të tjera më të buta në tre raste dhe në 6 gjykime është miratuar vendimi gjykatave të Shkallës së Parë për masë sigurimi.

Nga 123 (4 më pak se viti i kaluar) apeline të personave të dyshuar të shqyrtuara, Gjykata e Apelit ka ndryshuar vendimin duke caktuar masë sigurimi më të butë në 9 raste dhe për 93 raste gjykimi ka miratuar (lënë në fuqi) vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë. Nga Prokurori i Apelit në 11 apeline (7 më shumë se viti i kaluar) për masa sigurimi është hequr dorë, duke lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë.

Nga shqyrtimi i apelineve për vendime themeli, gjithsej 155 apeline të ushtruara nga Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore Gjirokastër, Sarandë, Përmet, nga prokuroria e Apelit janë pranuar 24 apeline. Është hequr dorë për 3 apeline, është vendosur mospranim apeli nga gjykata për 12 raste, është hequr dorë nga apeli dhe nga të pandehurit në 9 gjykime. Prokuroria e Apelit Gjirokastër në 87 (9 më pak se viti i kaluar) raste të ushtrimit të apelit ka kërkuar lënien në fuqi të vendimeve të Gjykatave të Shkallëve të Para. Janë lënë në fuqi 77 vendime, në 5 vendime është vendosur lehtësimi i pozitës së të pandehurit në dënime më të buta, në 5 vendime (2 më shumë nga viti i kaluar) është dhënë pafajsi ose pushim dhe në asnjë rast nuk është vendosur kthimi për rigjykim. Në 8 gjykime (13 më pak nga viti i kaluar) është kërkuar rëndimi i pozitës së të pandehurit. Gjykata ka pranuar 2 apeline dhe 6 apeline nuk janë pranuar (është lënë në fuqi vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë)

Në 15 vendime (6 më shumë nga viti i kaluar) të Gjykatave të Shkallës së Parë është kërkuar lehtësim i pozitës së të pandehurve në masë dënimi ose mënyrë të vuajtjes së dënimit. Gjykata e Apelit në 4 vendime ka lënë në fuqi vendimin e Shkallës së Parë, në 10 vendime ka lehtësuar pozitën e të pandehurve dhe në një vendim ka vendosur kthim për rigjykim. Në 2 vendime të gjykuar në Gjykatën e Apelit është kërkuar kthim i çështjes për rigjykim, kërkesa që janë pranuar nga Gjykata e Apelit.

Në 20 shqyrtime gjyqësore në Gjykatën e Apelit Gjirokastër, nga Prokuroria jën bërë 11 kërkesa për prishje të vendimit të pushimit ose pafajsisë, të vendimeve të gjykatave të Shkallëve të Para. Gjykata e Apelit ka pranuar 2 kërkesa për prishje të vendimit të pushimit ose pafajsisë dhe në 9 vendime ka lënë në fuqi vendimet e gjykatave të Shkallëve të Para.

Kërkesat e Prokurorit të Apelit për lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë, duke kundërshtuar apeli të pandehurve, në 87 vendime (9 më pak se viti i kaluar) është përkrahur nga gjykata në 77 vendime, për 5 vendime ka lehtësuar pozitën e të pandehurve, për 5 vendime (2 më shumë nga viti i kaluar) ka dhënë pafajsi.

Është rënduar pozita e të pandehurve në lloj dhe masë dënimi në bazë të kërkesës së prokurorit të apelit në 3 raste, nga 8 apeline të shqyrtuara, dhe është lënë në fuqi vendimi Gjykatës së Shkallës së Parë në 6 vendime.

Është pranuar kërkesa e prokurorit të Apelit nga Gjykata sipas ankimit të të pandehurit ose të prokurorit për të lehtësuar pozitën e tij në 10 raste, ku në 4 vendime është lënë në fuqi vendimi i gjykatave të Shkallës së Parë, në 1 vendim është vendosur kthimi i akteve për rigjykim.

Gjatë gjykimit të vendimeve të themelit, është dhënë vendim pafajsie nga Gjykata e Apelit në 8 vendime, për raste vendimi pafajsie me të arrestuar është ushtruar rekurs, ku për secilin vendim është ushtruar rekurs.

Nga Prokuroria e Apelit janë ushtruar 7 rekorse në Gjykatën e Lartë, të gjitha kundër vendimeve të themelit të dhëna nga Gjykata e Apelit Gjirokastër.

2. Treguesit e vendimeve për masa sigurimi

Gjykata e Apelit Gjirokastër në bazë të apelineve të Prokurorëve të rretheve Gjirokastër, Sarandë dhe Përmet si dhe të personave të dyshuar të gjykuar në këto rrethe, ka shqyrtuar 111 çështje me 143 persona të dyshuar. 18 apeline janë ushtruar nga Prokuroritë e Rretheve dhe 128 apeline janë ushtruar nga të pandehurit (personat e dyshuar nën hetim). 64 apeline i përkasin Rrethit Gjyqësor Gjirokastër, 41 apeline Rrethit Gjyqësor Sarandë dhe 6 apeline Rrethit Gjyqësor Përmet. Nga Prokuroria e Apelit janë përkrahur 6 kërkesa për ndryshim mase sigurimi duke kërkuar caktimin e masës së sigurimit “arrest në burg” dhe në 4 raste masë sigurimi më të butë. Nga Gjykata e Apelit në 1 vendim është ndryshuar vendimi i Gjykatës të Shkallës së Parë duke caktuar masë sigurimi “arrest në burg”, ndërsa në 6 raste nga Gjykata e Apelit është ndryshuar masa e sigurimit nga “arrest në burg” në një masë më të butë sigurimi dhe në 93 vendime ka lënë në fuqi (miratuar) vendimin e gjykatave të Shkallës së Parë. Nga këto shqyrtime gjyqësore rezulton se 18 apeline janë bërë nga prokurorët e seancave kundër masave më të lehta të vendosura nga gjykatat e Shkallës së Parë dhe 123 apeline janë bërë nga të pandehurit ku kërkohen masa më të buta sigurimi. Gjykata e Apelit Gjirokastër në bazë të apelineve në 12 (5 më shumë se viti i kaluar) raste ka vendosur mospranim ankimi (në 11 apeline ka hequr dorë prokurori i Apelit, në 1 apelim ka hequr dorë personi i dyshuar). Në 1 apelim Gjykata e Apelit ka ndryshuar masën e sigurimit sipas kërkesave të prokurorit dhe në 6 raste ka zbutur masën e sigurimit në masa më të buta. Prokuroria e Apelit në 123 apeline të të pandehurve për masa më të buta sigurimi ka kërkuar miratimin e vendimeve të gjykatave të Shkallës së Parë në 102 raste, ndërsa Gjykata e Apelit ka miratuar 93 vendime (lënë në fuqi)

dhe në 6 raste ka dhënë vendime për masa më të buta sigurimi dhe në 3 raste ka vendosur shfuqizim vendimi (rrëzim kërkesë).

Nga Prokuroria e Apelit nuk është ushtruar një rekurs në Gjykatë e Lartë, kundër vendimit të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë për masa sigurimi.

Rrethi Gjyqësor Gjirokastrë:

Janë apeluar 48 vendime themeli (32 më pak se viti i kaluar) me 64 të pandehur, nga të cilët 38 me masë sigurimi “arrest në burg”. Nga këto 9 (19 më pak se viti i kaluar) apeline janë ushtruar nga Prokurorët dhe dhe 44 vendime janë apeluar nga të pandehurit (36 më pak nga viti i kaluar). Pra Prokuroria e Gjirokastrës ka apeluar 9 vendime themeli, nga të cilët 6 për pafajsi, 1 për ndryshim kualifikimi dhe 2 vendime për masë dënimi më të butë. Të pandehurit kanë apeluar 44 vendime. Ka 2 raste të heqjes dorë nga prokurori i Apelit dhe 6 raste kanë hequr dorë nga ankimi të pandehurit. Nga Prokurori i Apelit janë bërë 31 kërkesa për lënie në fuqi të vendimit, ku Gjykata e Apelit në 25 vendime ka vendosur lënie në fuqi, në 3 vendime ka lehtësuar pozitën e të pandehurve, në 3 vendime ka vendosur pafajsi. Nga 4 apeline të prokurorisë Gjirokastrë për rëndim të pozitës së të pandehurit, Gjykata e Apelit nuk ka pranuar asnjë rast, në 2 vendime ka lënë në fuqi vendimin e Shkallës së Parë, në një vendim ka vendosur pushim çështje dhe në një vendim ka vendosur kthim për rigjykim. Nga 4 apeline të Prokurorisë Gjirokastrë për vendime pafajsie, Gjykata e Apelit në 3 raste ka vendosur lënie në fuqi të vendimit të Shkallës së Parë dhe në 1 vendim ka vendosur fajësi, për të gjitha këto vendime (pafajsi) nga Prokuroria e Apelit është ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë.

Nga Rrethi Gjyqësor Gjirokastrë janë ushtruar 64 apeline për masa sigurimi (4 apeline më shumë se viti i kaluar), ku 15 (4 më shumë nga viti i kaluar) apeline janë ushtruar nga Prokuroria dhe 67 apeline janë ushtruar nga personat e dyshuar, të arrestuar ose ndaluar. Në 8 raste apeli të Prokurorisë Gjirokastrë është hequr dorë nga prokurori i Apelit dhe është vendosur mospranim ankimi. Nga shqyrtimi i 7 apelineve të Prokurorisë Gjirokastrë, Gjykata e Apelit në 1 vendim ka pranuar apelin duke vendosur masën e sigurimit “arrest në burg”, në 6 vendime ka miratuar (lënë në fuqi) vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë.

Rrethi Gjyqësor Sarandë:

Janë apeluar 56 vendime themeli (27 më pak se viti i kaluar) me 90 të pandehur (1 më pak se viti i kaluar), nga të cilët 53 (6 më shumë se viti i kaluar) me masë sigurimi “arrest në burg”. Prokuroria ka apeluar 7 vendime (11 më pak se viti i kaluar), nga të cilët 2 për pafajsi, 2 për pushim çështje dhe 3 vendime për

masë dënimi më të butë. Të pandehurit kanë apeluar 71 vendime (5 më shumë se viti i kaluar).

Prokurori i Apelit në 1 gjykim ka hequr dorë nga apelimi ndërsa të pandehurit kanë hequr dorë nga apelimi në 3 raste. Nga Prokurori i Apelit janë bërë 39 kërkesa për lënie në fuqi të vendimit, ku Gjykata e Apelit në 35 vendime ka vendosur lënie në fuqi, në 2 vendime ka vendosur lehtësimin e pozitës së të pandehurve, në 2 vendim ka vendosur pafajsi. Nga 2 apeline të prokurorisë Sarandë për rëndim të pozitës së të pandehurit, Gjykata e Apelit në të dy rastet ka vendosur lënien në fuqi, të vendimit. Nga 5 apeline (1 më pak nga viti i kaluar) të Prokurorisë për vendime pafajsie, Gjykata e Apelit në 4 raste ka vendosur lënie në fuqi të vendimit të Shkallës së Parë dhe në 1 vendim ka vendosur fajësi. Nga Rrethi Gjyqësor Sarandë janë ushtruar 41 (26 më pak nga viti i kaluar) apeline për masa sigurimi, ku 3 apeline (një më pak nga viti i kaluar) janë ushtruar nga Prokuroria dhe 50 apeline nga personat e dyshuar. Është hequr dorë nga Prokurori i Apelit në të tre rastet e apelimit të prokurorisë Sarandë.

Rrethi Gjyqësor Përmet:

Janë apeluar 23 vendime themeli (8 më shumë se viti i kaluar) me 31 të pandehur, nga të cilët 18 me masë sigurimi “arrest në burg”. Prokuroria ka apeluar 4 vendime (6 më pak se viti i kaluar), nga të cilët 2 vendime për pafajsi, 1 vendim për ndryshim kualikimi dhe 1 vendim për masë dënimi më të butë. Të pandehurit kanë apeluar 10 (13 më shumë nga viti i kaluar) vendime të Gjykatës së Shkallës së Parë. Nuk është hequr dorë në asnjë rast nga apelimi i prokurorit. Nga Prokurori i Apelit janë bërë 17 kërkesa për lënie në fuqi të vendimit, ku Gjykata e Apelit në të gjitha rastet ka vendosur lënien në fuqi. Nga 2 apeline të prokurorisë Përmet për rëndim të pozitës së të pandehurit, Gjykata e Apelit në 2 vendime ka vendosur lënie në fuqi të vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë dhe 3 vendime ka vendosur rëndimin e pozitës së të pandehurve në masë dënimi dhe mënyrë të vuajtjes së dënimit. Nga 3 kërkesa të prokurorit të Apelit për lehtësim të pozitës së të pandehurit, Gjykata e Apelit ka pranuar duke lehtësuar pozitën e të pandehurve. Nga 2 apeline të Prokurorisë Përmet për vendime pafajsie, Gjykata e Apelit nuk ka pranuar asnjë apelim, duke lënë në fuqi vendimet e Shkallës së Parë.

Nga Rrethi Gjyqësor Përmet janë ushtruar 6 apeline (9 më pak nga viti i kaluar) për masa sigurimi, ku nga Prokuroria nuk është ushtruar asnjë apelim. Nga Prokurori i Apelit është pranuar një apelim nga të dyshuarit, ku është kërkuar masë më e buti sigurimi ku është përkrahur dhe Gjykata e Apelit ka vendosur pranimin e apelimit duke vendosur masën e sigurimit të kërkuar. Në 5 apeline të personave të dyshuar Gjykata e Apelit ka miratuar (lënë) në fuqi 4 vendime të Gjykatës së

Shkallës së Parë dhe në një rast ka pranuar apelimin e personit të dyshuar duke dhënë një masë dënimi më të butë.

3. Vendimet e themelit të apeluara sipas veprave penale

Në krahasim me vitin e kaluar, gjatë vitit 2018, në Gjykatën e Apelit Gjjirokastër janë shqyrtuar 278 çështje themeli, duke përfshirë dhe shqyrtimet e çështjeve që nuk pasqyrohen në statistikë (kundërshtim vendim/mosfillimi, rivendosje në afat, zgjatje afati hetimi dhe paraburgimi etj.).

Prokurori **Alfred Agolli**, ka marrë pjesë në 138 çështje penale të shqyrtuara në Gjykatën e Apelit Gjjirokastër.

Prokurori **Gjon Fusha** ka marrë pjesë në 140 çështje penale të shqyrtuara në gjykatën e Apelit Gjjirokastër.

Theksoj se me ndryshimet e fundit të K.Pr.Penale çështjet penale me objekt prishje vendim pushimi si dhe rishikim vendimi, zhvillohen në dhomë këshillimi, pa pjesëmarrjen e prokurorit.

Rastet e gjykuara sipas veprave penale më të shumta janë si më poshtë:

- Për nenin 283 të K.Penal (prodhim shitje narkotikëve), gjithsej janë shqyrtuar 28 apeline (6 apeline më shumë se viti i kaluar), ku 2 apeline janë ushtruar nga prokurorët, nga të cilat 1 apelim për pafajsi dhe 1 apelim për masë të butë dënimi. Nga apelimet e prokurorëve është pranuar 1 apelim nga Gjykata e Apelit duke kthyer çështjen për rigjykim dhe për një apelim është lënë në fuqi vendimi Gjykatës së Shkallës së Parë.
- Për nenin 283 të K.Penal (trafikim i narkotikëve), gjithsej janë shqyrtuar 2 apeline të ushtruara nga të pandehurit, ku për 1 ankim është vendosur mospranim ankimi dhe për të dytin është vendosur lënie në fuqi të vendimit Gjykatës së Shkallës së Parë.
- Për nenin 284 të K.Penal (kultivimi i narkotikëve) nuk është shqyrtuar asnjë vendim gjyqësor.
- Për nenin 134 të K.Penal (vjedhja) janë shqyrtuar 15 apeline (10 apeline më pak se viti i kaluar), ku 3 apeline të ushtruar nga prokurorët për pafajsi dhe lloj masë dënimi të butë (1) dhe 19 apeline nga të pandehurit. Gjykata e Apelit në të tre apelimet e prokurorëve ka lënë në fuqi vendimin e Shkallës së Parë. Në 19 apeline të të pandehurve, 11 vendime janë lënë në fuqi, në 1 vendim është lehtësuar pozita e të pandehurve.
- Për nenin 135 (vjedhje duke shpërdoruar detyrën) të K.Penal është shqyrtuar 1 vendim me ankim prokurorie për pafajsi, ku gjykata e Apelit ka dhënë fajësi.

- Për nenin 199/a të K.Penal (ndërtimi i paligjshëm) në Gjykatën e Apelit për vitin 2018 nuk ka pasur shqyrtim gjyqësor.
- Për nenin 78 të K.Penal (vrasje me paramendim) në Gjykatën e Apelit janë shqyrtuar 2 çështje penale me ankim të të pandehurve ku Gjykata e Apelit ka lënë në fuqi vendimin e Shkallës së Parë.
- Për nenin 248 të K.Penal (shpërdorimi i detyrës) janë shqyrtuar 4 çështje penale me 9 të pandehur të lirë. Nga Prokuroria e Shkallës së Parë janë ushtruar 3 apeline (2 pafajsi dhe 1 masë dënimi të butë) ndërsa nga të pandehurit 3 apeline. Gjykata e Apelit në 2 rastet e apelimet të prokurorisë ka vendosur lënie në fuqi të vendimit të Shkallës së Parë (pafajësi) ku nga prokuroria e Apelit është ushtruar rekurs. Dhe, për 1 apelim të të pandehurit është vendosur vendosur kthim për rigjykim.
- Për nenin 259 të K.Penal (korrupsioni pasiv) për vitin 2018 nuk është shqyrtuar asnjë apelim.
- Për nenin 290 të K.Penal (shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor) janë shqyrtuar 5 apeline (6 më pak se viti i kaluar) me 5 të pandehur, nga të cilët 4 me masë sigurimi “arrest në burg”. Nga prokuroria është ushtruar një apelim për pafajsi, ku është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit. Në një rast të apalimit të të pandehurit Gjykata e Apelit ka pranuar ankimin dhe vendosur pafajsi dhe për këtë rast është ushtruar rekurs.
- Për nenin 130/a të K.Penal (dhuna në familje) janë shqyrtuar 5 apeline (2 më pak se viti i kaluar), të gjitha apelimet të ushtruara nga të pandehurit. Nga Gjykata e Apelit vendimet janë lënë në fuqi.
- Për nenin 298 të K.Penal (ndihmë për kalim të paligjshëm të kufirit) janë shqyrtuar 3 apeline me 5 të pandehur me masë sigurimi “arrest në burg të ushtruara nga të pandehurit, ku të 3 vendimet janë lënë në fuqi.
- Për nenin 278 të K.Penal (mbajtja pe lejë e armëve luftarake...), janë shqyrtuar 5 çështje me 8 të pandehur, 6 me masë sigurimi “arrest në burg”, një vendim është apeluar nga prokuroria për masë dënimi të butë, Gjykata e Apelit ka vendosur lënie në fuqi të vendimit.
- Për nenin 141 (vjedhje me pasojë vdekjen) është shqyrtuar një çështje me apelim të të pandehurit ku Gjykata e Apelit ka vendosur lënie në fuqi.
- Për nenin 291 të K.Penal (drejtim i mjetit në mënyrë të paregullt) janë shqyrtuar 3 apeline (10 më pak se viti i kaluar), ku 1 apelim është ushtruar nga prokuroria, për masë të butë dënimi dhe dy apeline nga të pandehurit. Nga prokuroria e Apelit është hequr dorë nga 1 apelim dhe është kërkuar lehtësim i pozitës së të pandehurit në mënyrën e vuajtjes së dënimit për 2 apeline, të cilat janë pranuar nga Gjykata e Apelit.

- Për nenin 88 (plagosje e rëndë me dashje) janë shqyrtuar 2 çështje penale me aplim të të pandehurve, me 2 të pandehur në gjendje të lirë. Gjykata në të dy rastet ka vendosur lënie në fuqi të vendimit të Shkallës së Parë.

4. Rekurse.

Prokuroria e Apelit ka ushtruar 8 rekurse (10 më pak se viti i kaluar) në Gjykatën e Lartë. Të gjitha rekursat janë ushtruar kundër vendimeve të themelit të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë.

Prokurori Alfred Agolli ka ushtruar në Gjykatën e Lartë 1 rekurs për vendim themeli.

Prokurori Gjon Fusha ka ushtruar në Gjykatën e Lartë 7 rekurse për vendime themeli.

5. Urdhëra ekzekutimi.

- Për vitin 2018 nga Prokuroria e Apelit Gjirokastrë janë lëshuar 11 urdhëra ekzekutimi të menjëhershëm.

Këta janë disa nga treguesit kryesorë e punës së kryer gjatë vitit 2018 në Prokurorinë e Apelit Gjirokastrë.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin!

PROKURORI I APELIT
Alfred AGOLLI